



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.162

8 dhjetor

2010

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr.6751 datë 9.11.2010	Për lejim lënieje të shtetësisë shqiptare	8447
Vendim i KM nr.886, datë 3.11.2010	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të bashkisë Belsh, të qarkut të Elbasanit	8448
Vendim i KM nr.896, datë 10.11.2010	Për disa ndryshime në vendimin nr.795, datë 6.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve “Master profesional”, për vitin akademik 2010-2011”	8449
Vendim i KM nr.897, datë 10.11. 2010	Për disa ndryshime në vendimin nr.954, datë 30.9.2009 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin, strukturën, funksionimin e Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD) dhe bashkëveprimin me institucionet shtetërore, që kanë interesa në det”, të ndryshuar	8453
Vendim i KM nr.898, datë 10.11. 2010	Për disa ndryshime në vendimin nr.114, datë 31.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e masës së kontributeve të personave që vendosen në institucionet rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror”	8454
Vendim i KM nr.899, datë 10.11. 2010	Për një shtesë në vendimin nr.632, datë 18.9.2003 të Këshillit të Ministrave “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkesve të papunë, femra”, të ndryshuar	8454

Vendim i KM nr.900, datë 10.11.2010	Për rishpërndarje fondesh buxhetore, për shpenzime korente, ndërmjet programeve, brenda buxhetit të vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	8455
Vendim i KM nr.901, datë 10.11. 2010	Për disa ndryshime në vendimin nr.786, datë 29.9.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve “Master i shkencave”, për vitin akademik 2010-2011”	8455
Vendim i KM nr.903, datë 10.11.2010	Për rishpërndarje fondesh, për shpenzime kapitale, ndërmjet programeve brenda buxhetit të vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave	8461
Vendim i KM nr.959, datë 24.11.2010	Për shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së nënshkruar, për procedurat e prokurimit publik të kryera nga Ministria e Brendshme, si autoritet kontraktor	8461
Vendim i KM nr.960, datë 26.11.2010	Për lejimin e realizimit të procedurave dhe shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të fituesit e të njoftimit të kontratës së lidhur, për procedurat e prokurimit, të kryera nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, institucionet në varësi të saj dhe njësitë e pushtetit vendor, për punimet e projekteve të reja në arsim, si autoritete kontraktore	8463
Vendim i KM nr.962, datë 24.11.2010	Për shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të kontratës së lidhur, për procedurat e prokurimit të kryera nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, si autoritet kontraktor	8464
Udhëzim i MF nr.9/1, datë 15.11.2010	Për një ndryshim në udhëzimin nr.9, datë 15.3.2010 “Për procedurat dhe afatet e rishpërndarjes së bonove të investuara në fondet e investimeve, të krijuara në përputhje me ligjin nr.7979, datë 26.7.1995 “Për fondet e investimeve””	8464
Urdhër i MD nr.9023, datë 1.11.2010	Për formën, përmbajtjen dhe administrimin e regjistrave të noterëve dhe asistentëve, si dhe për dokumentacionin që përmbajnë dosjet e noterëve e asistentëve	8465
Kërkesë e MPPT nr.3723/4, datë 15.11.2010	Për shpronësim, për interes publik, të kulturave bujqësore dhe drufrutorë, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Levan-Vlorë (seksioni i dytë).....	8472

DEKRET
Nr.6751, datë 9.11.2010

PËR LEJIM LËNIEJE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Alfred Hamzo Tare
2. Antuela Adhurim Papa (Shametaj)
3. Ariana Selim Strumi
4. Armanda Mustafa Cebula (Aliaj)
5. Elton Agron Hoxha
6. Gentiana Naim Krause (Gjoshi)
7. Henri Osman Luli
8. Ida Llazaraq Tërova-Ferch (Tërova)
9. Julia Osman Luli
10. Klaudia Ismet Cara
11. Lavdije Agim Ymeri (Hakrama)
12. Mateos Liçi
13. Mimoza Vangjel Ballgjini (Bici)
14. Mirdjana Ferik Stahl (Merdani)
15. Nerënxa Çoban Luli (Kamberaj)
16. Petrit Teti Selenica
17. Ramazan Latif Arbana
18. Saimir Syrja Deliallisi
19. Sergjo Simon Pohja
20. Suela Prel Nica
21. Valdete Isni Topali (Kurzmalaj)
22. Violanda Zeqir Müller (Mulgeci)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr.886, datë 3.11.2010

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË BELSH, TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ të bashkisë Belsh të qarkut të Elbasanit, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 177 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 1306 (një mijë e treqind e gjashtë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkia e Belshit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Belsh

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
5	Prona që përdoren në fushën administrative	Në pronësi
6-16	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
21-53	Shërbim funeral	Në pronësi
54-150	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
151-291 (vetëm trojet)	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
151-291 (vetëm sheshet)	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
292-306	Prona që përdoren në fushën strehimit dhe të mbrojtjes civile	Në pronësi
307-309, 315, 323, 324, 340, 341, 343, 344, 345, 347, 350, 351, 352, 357, 358, 362, 363, 365, 368, 369, 371, 374, 375, 379, 380, 387	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
311, 312, 316, 317, 318, 326, 328, 329, 348, 349, 354, 355, 356, 360, 361, 366, 367, 372, 373, 377, 378, 383, 384, 385, 386, 389, 390, 391, 392, 393, 394-672 (vetëm kanalet e treta)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka inproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
676-1236	Infrastrukturë vendore (rrugë)	Në pronësi

VENDIM
Nr.896, datë 10.11.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.795, DATË 6.10.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT NË
INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE
“MASTER PROFESIONAL”, PËR VITIN AKADEMIK 2010-2011”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 34, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidëve të punës”, të ndryshuar, të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr.10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit” dhe të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.795, datë 6.10.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, për programet e studimeve të ciklit të dytë, për vitin 2010-2011, të jenë 7964. Këto kuota të ndahen, si më poshtë vijon:

- | | | |
|-----|--|-------|
| a) | Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master profesional” | 7774; |
| b) | Kuotat për programe të dyta studimi | 0; |
| c) | Kuota për transferimin e studimeve | 100; |
| ç) | Kuota për të huajt | 50; |
| d) | Kuota për të verbrit | 20; |
| dh) | Kuota për romët/ballkano-egjiptianët | 20.”. |

2. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Kuotat e pranimeve të reja, për programet e studimeve të ciklit të dytë “Master profesional”, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të këtij vendimi, përbëhen nga:

- | | | |
|----|---|--------|
| a) | Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master profesional”, për kandidatët brenda territorit të vendit | 6997; |
| b) | Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master profesional”, për kandidatët shqiptarë nga trojet jashtë territorit të vendit | 777.”. |

3. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master profesional”, në përputhje me përcaktimet e shkronjës “a” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahen sipas programeve të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë, paraqitur në tabelën nr.1/1, bashkëlidhur këtij vendimi.”.

4. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Kuotat e pranimeve të reja, për programet e studimit të ciklit të dytë, sipas shkronjës “b” të pikës 2 të këtij vendimi, ndahen ndërmjet kandidatëve shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit: Republika e Kosovës, Maqedoni, Mali i Zi, Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë. Administrimi i këtyre kuotave kryhet në bazë të marrëveshjeve dypalëshe ndërmjet vendeve dhe akteve të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Shqipërisë. Këto kuota pranimi të ndara sipas programeve të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë, për çdo program studimi, janë në masën 10% të kuotës përkatëse, paraqitur në tabelën nr.1/1, bashkëlidhur këtij vendimi.”.

5. Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“11. Tarifat vjetore të shkollimit për studentët, që do të regjistrohen në vitin e parë, për të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional”, në vitin akademik 2010-2011, si dhe tarifat vjetore të shkollimit për studentët, që ndjekin një program të dytë studimi, janë sipas tabelës nr.2/1, bashkëlidhur këtij vendimi.”.

II. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TABELA NR.1/1
TABELA E KUOTAVE “MASTER PROFESIONAL”

Nr.	Emërtimet e programeve të studimit	UT	UPT	UBT	UE	USH	UK	UGJ	UV	UD	AKMB	UST	Shuma
		2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	
1	Mësuesi në CLAB në Gjuhë-letërsi	30			60	100	70	70					330
2	Mësuesi në CLAB në Biologji-kimi				80	100		60					240
3	Mësuesi në CLAB në Gjuhë italiane				35	60		40					135
4	Mësuesi në CLAB në Gjuhë gjermane				25	60							85
5	Mësuesi në CLAB në Gjuhë frënge				30	60							90
6	Mësuesi në CLAB në Gjuhë angleze				80	100	50	60					290
7	Mësuesi në CLAB në Matematikë-Fizikë				70	60	20	60					210
8	Mësuesi në CLAB në Matematikë-informatikë				30	60		60	150				300
9	Mësuesi në CLAB në Histori-geografi				60	100		70					230
10	Mësuesi në CLAB në lëndën Edukim fizik dhe sporte					60							60
11	Mësuesi në CLAB në gjuhën greke për lëndët shoq.							25					25
12	Përkth. dhe Adm i vlerave të kulturës tradicion							25					25
13	Mësuesi në AM në Shkenca sociale	50					50						100
14	Mësuesi në AM në Gjuhë angleze	150				30			150				330
15	Mësuesi në AM në Gjuhë frënge	60				30							90
16	Mësuesi në AM në Gjuhë gjermane	60				30							90
17	Mësuesi në AM në Gjuhë italiane	80				30			150				260
18	Mësuesi në AM në Gjuhë letërsi	120				30	50						200
19	Mësuesi në AM në Histori	150				30							180
20	Mësuesi në AM në Gjeografi	120				30							150
21	Mësuesi në AM në Kimi	50				30							80
22	Mësuesi në AM në Biologji	60				30							90
23	Mësuesi në AM në Fizikë	50											50
24	Mësuesi në AM në Matematikë-fizikë					30			150				180
25	Mësuesi në AM në Matematikë	80							150				230
26	Informatikë biznesi												0
27	Trainingu sportiv												0
28	Mësues për AM fiskulturë					30						80	110
29	Stërvitje sportive											59	59
30	Mësuesi në AM në Informatikë								150				150
31	Shëndet Publik	20											20
32	Menaxhim infermieror	330			100								430
33	Teknik laborator	40											40
34	Mami	40											40
35	Fizioterapi	40											40
36	Imazheri	50											50
37	Teknologji informacioni	40											40
38	Zhvillim i integruar rural						40						40
39	Operacione industriale dhe navale								70				70
40	Edukatë qytetare dhe gjeografi				60								60
41	Edukatë qytetare dhe histori				70								70
42	Redaktim	60			30								90
43	Drejtim dhe administrim arsimit	60											60
44	Qeverisje dhe politikat publike	70											70

45	Këshillim psikologjik	50											50
46	Orientim profesional	60											60
47	Punë sociale	80											80
48	Filozofi praktike dhe humane	30											30
49	Shkenca sociale						30						30
50	Analizë e politikës sociale	80											80
51	Shëndet publik veterinar			30									30
52	Shëndeti i kafshëve			30									30
53	Teknologji e avancuar në hortikulturë			30									30
54	Mbrojtja kimike dhe fitofarmacia			25									25
55	Biznes blegtoral			25									25
56	Teknologji e kultivimit të bimëve			40									40
57	Menaxhim mjedisi			40									40
58	Menaxhim i ndërmarrjeve												0
59	Ekonomi dhe agrobiznes												0
60	Ekonomi dhe politikë agrare												0
61	Redaktori												0
62	Gazetar reporter					25							25
63	Gazetari sportive					25							25
64	Gjuhësi					20							20
65	Gjeomorfologji												0
66	Arkivistikë	60											60
67	Sipërmarrje dhe turizëm								150				150
68	Kontabilitet financë							90					90
69	Administrim publik							70	150	50			270
70	Administrim biznesi									50			50
71	Bisnes Laë	60											60
72	Menaxhim administrim financiar									50			50
73	Marketing									50			50
74	Turizëm							60		50			110
75	Financë bankë									50			50
76	Menaxhim i SME									50			50
77	Përkthim dhe interpretim në gjuhë gjermane					20							20
78	Inxhinieri mekanike		30										30
79	Inxhinieri tekstile dhe mode		25										25
80	Infermieristikë									150			150
81	Studime të avancuara detare									150			150
82	Punonjës socialë me fëmijët dhe familjen					120							120
83	Psikolog në institucione					80							80
84	Në fushën e mbrojtjes										100		100
	Shuma	2230	55	220	1000	1110	310	690	1570	350	100	139	7774

TABELA NR.2/1

TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR PROGRAMET E STUDIMIT “MASTER PROFESIONAL” ME KOHË TË PLOTË, NË TË GJITHA INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË NË VITIN AKADEMIK 2010-2011

a) Për programet e studimit “Master profesional”, në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë, të jetë:

i) Për lëndët fizikë, matematikë, informatikë apo kombinimet e tyre 31.500 lekë
ii) Të gjitha programet e tjera 42.000 lekë

b) Për programet e studimit “Master profesional”, në mësuesi për arsimin e mesëm, të jetë:

i) Për lëndët fizikë, matematikë, informatikë apo kombinimet e tyre 42.000 lekë
ii) Të gjitha programet e tjera 47.250 lekë

c) Për të gjitha programet e tjera “Master profesional”, 63.000 lekë

Tarifat e shkollimit për programet e dyta të studimit “Master profesional” me kohë të plotë, në të gjitha institucionet publike të Arsimit të Lartë në vitin akademik 2010-2011.

a) Për programet e studimit “Master profesional”, në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë, të jetë:

i) Për lëndët fizikë, matematikë, informatikë apo kombinimet e tyre 63.000 lekë
ii) Të gjitha programet e tjera 84.000 lekë

b) Për programet e studimit “Master profesional”, në mësuesi për arsimin e mesëm, të jetë:

i) Për lëndët fizikë, matematikë, informatikë apo kombinimet e tyre 84.000 lekë
ii) Të gjitha programet e tjera 105.000 lekë

c) Për programet e tjera “Master profesional”:

i) Në Fakultetin e Infermierisë 210.000 lekë
ii) Të gjitha programet e tjera 105.000 lekë

VENDIM

Nr.897, datë 10.11.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.954, DATË 30.9.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR ORGANIZIMIN, STRUKTURËN, FUNKSIONIMIN E QENDRËS NDËRINSTITUCIONALE OPERACIONALE DETARE (QNOD) DHE BASHKËVEPRIMIN ME INSTITUCIONET SHTETËRORE, QË KANË INTERESA NË DET”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 32 të ligjit nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të neneve 3, pika 3 e 4/1, pika 3 e ligjit nr.8875, datë 4.4.2002 “Për Rojën Bregdetare Shqiptare”, të ndryshuar, dhe të neneve 6, 29 e 41 të ligjit nr.9861, datë 24.1.2008 “Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.954, datë 30.9.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Në paragrafin e parë të pikës 7 të kreut III, fjalët “... i cili caktohet nga Ministri i Mbrojtjes ...” zëvendësohen me “ ... i cili caktohet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes ...”.

b) Pika 1 e kreut IV, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Veprimtaria operationale e Qendrës Ndërinstitucionale Operationale Detare përcaktohet në dokumentin “Politikat dhe procedurat e funksionimit të Qendrës Ndërinstitucionale Operationale Detare”, i cili miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

c) Pika 2 e kreut VI shfuqizohet.

2. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

8453

VENDIM
Nr.898, datë 10.11.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.114, DATË 31.1.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË KONTRIBUTEVE TË PERSONAVE QË
VENDOSEN NË INSTITUCIONET REZIDENCIALE PUBLIKE TË PËRKUJDESIT
SHOQËROR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 3 të nenit 23 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, më propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.114, datë 31.1.2007 të Këshillit të Ministrave, të bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 2 fjalët “... 50% të pensionit ...” zëvendësohen me “... 40 për qind të pensionit ...”.

2. Në shkronjën “ç”, të pikës 3, fjalët “... në masën 4 000 (katër mijë) lekë në muaj ...” zëvendësohen me “... në masën 6 000 (gjashtë mijë) lekë në muaj ...”.

3. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi të përballohen nga fondet e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, të miratuara në buxhetin e vitit 2010.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data e hyrjes në fuqi të tij.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.899, datë 10.11.2010

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.632, DATË 18.9.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT TË PUNËKËRKUESVE TË PAPUNË,
FEMRA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 8 të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 4 të vendimit nr.632, datë 18.9.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas fjalës “ ... sociale ...” shtohen fjalët “... emigrante të kthyer, me probleme ekonomike ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.900, datë 10.11.2010

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH BUXHETORE, PËR SHPENZIME KORENTE, NDËRMJET
PROGRAMEVE, BRENDA BUXHETIT TË VITIT 2010, MIRATUAR PËR MINISTRINË E
PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TË BARABARTA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 16 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve, për shpenzime korente, ndërmjet programeve, brenda buxhetit të vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, si më poshtë vijon:

- a) Programit “Tregu i punës”, për vitin 2010, t’i shtohet fondi 40 000 000 (dyzet milionë) lekë.
- b) Programit “Mbrojtja sociale”, për vitin 2010, t’i pakësohet fondi 40 000 000 (dyzet milionë) lekë.

2. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.901, datë 10.11.2010

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.786, DATË 29.9.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT NË
INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE
“MASTER I SHKENCAVE”, PËR VITIN AKADEMIK 2010-2011”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 34, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidëve të punës”, të ndryshuar, të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr.10289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit” dhe të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.786, datë 29.9.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, për programet e studimeve të ciklit të dytë, për vitin 2010-2011, të jenë 6520. Këto kuota të ndahen, si më poshtë vijon:

- | | |
|---|-------|
| a) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master i shkencave” | 6330; |
| b) Kuotat për programe të dyta studimi | 0; |
| c) Kuota për transferimin e studimeve | 100; |
| ç) Kuota për të huajt | 50; |
| d) Kuota për të verbrit | 20; |
| dh) Kuotat për romët/ballkano-egjiptianët | 20.”. |

2. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Kuotat e pranimeve të reja, për programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i shkencave”, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të këtij vendimi, përbëhen nga:

a) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master i shkencave”, për aplikantët brenda territorit të vendit 5700;

b) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master i shkencave”, për aplikantët shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit 630.”.

3. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master i shkencave”, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahen sipas programeve të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë, paraqitur në tabelën nr.1/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

4. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Kuotat e pranimeve të reja, për programet e studimit të ciklit të dytë, sipas shkronjës “b” të pikës 2 të këtij vendimi, ndahen ndërmjet aplikantëve shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit: Republika e Kosovës, Maqedoni, Mali i Zi, Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë. Administrimi i këtyre kuotave kryhet në bazë të marrëveshjeve dypalëshe ndërmjet vendeve dhe akteve të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Shqipërisë. Këto kuota pranimi të ndara sipas programeve të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë, për çdo program studimi, janë në masën 10% të kuotës përkatëse, paraqitur në tabelën nr.1/1, bashkëlidhur këtij vendimi.”.

5. Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“11. Tarifat vjetore të shkollimit për studentët, që do të regjistrohen në vitin e parë, për të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave”, në vitin akademik 2010-2011, si dhe tarifat vjetore të shkollimit për studentët, që ndjekin një program të dytë studimi, janë sipas tabelës nr.2/1, bashkëlidhur këtij vendimi.”.

II. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TABELA NR.1/1
TABELA E KUOTAVE “MASTER I SHKENCAVE” 2010-2011

Nr.	Emërtimet e programeve të studimit	UT	UPT	UBT	UE	USH	UK	UGJ	UV	UD	UST	AKMB	Shuma
		2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	
1	Biologji mjedisore	15				30							45
2	Biologji molekulare	30											30
3	Fizikë	20							40				60
4	Bioteknologji	25											25
5	Kimia industriale dhe mjedisore	40											40
6	Inxhinieria e proceseve kimike	40											40
7	Shkencat dhe teknologjitë ushqimore	40											40
8	Kimi	45											45
9	Matematikë	45											45
10	Matematikë dhe financë								120				120
11	Mësues në AM në Biologji	60											60
12	Mësues në AM në Kimi	50											50
13	Mësues në AM në Fizikë	50											50
14	Mësues në Shkenca sociale	50											50
15	Mësues për gjuhën angleze	30											30
16	Mësues në AM në Matematikë	80											80
17	Edukim Special								40				40
18	Inxhinieri Matematike dhe Informatike	45											45
19	Informatikë	50											50
20	Gjuhë e komunikim ndërkult. e turistik	130											130
21	Përkth. teknik-letrar dhe interpretim	130											130
22	Gjuhësi	125			21								146
23	Letërsi	113											113
24	Histori	37											37
25	Mësuesi Gjuhë angleze	150											150
26	Mësuesi Gjuhë italiane	80											80
27	Mësuesi Gjuhë frënge	60											60
28	Mësuesi Gjuhë gjermane	60											60
29	Gjeografi	62											62
30	Arkeologji	19											19
31	Trashëgimi kulturore	19			30								49
32	Marrëdhënie ndërkombëtare	35											35
33	Gazetari	100											100
34	Përkatesi gjinore dhe zhvillim	105											105
35	Psikolog edukimi				60								60
36	Psikolog shkollor/organizacional	60											60
37	Psikolog klinik i zhvillimit dhe marrëdh.	60											60
38	Filozofi sociale	85					40						125
39	Mësuesi në fakultetin e Shkencave Sociale	10											10
40	Teori politike	67											67
41	Sociologji e zhvillimeve shoqërore	73											73
42	Punë sociale	125											125
43	Menaxhim infermieror	220											220
44	Teknikë laborator	70											70

45	Fizioterapi	80											80
46	Mami	55											55
47	Imazheri	70											70
48	Shëndet publik	48											48
49	Inxhinieri elektronike		25										25
50	Inxhinieri e telekomunikacionit		25										25
51	Inxhinieri informatike		25										25
52	Inxhinieri elektrike												0
53	Inxhinieri elektrike (Energjetikë, Aut i industrisë)		60										60
54	Inxhinieri mekanike		70										70
55	Inxhinieri materiale		30										30
56	Inxhinieri tekstili dhe mode		30										30
57	Inxhinieri gjeologjike		60										60
58	Inxhinieri e burimeve natyrore		40										40
59	Inxhinieri gjeofizike		15										15
60	Inxhinieri gjeomjediti		20										20
61	Inxhinieri mjediti		65										65
62	Inxhinieri ndërtimi		165										165
63	Inxhinieri hidroteknikë		35										35
64	Inxhinieri gjeodezi		45										45
65	Inxhinieri agrare(hortik.,mbrojt.bimësh., zootek.,kuak)			130									130
66	Inxhinieri agromjediti (agromjediti dhe ekologji)			50									50
67	Inxhinieri agroushqimore			50									50
68	Vreshtari-enologji			20									20
69	Inxhinieri përpunim druri			30									30
70	Inxhinieri pyjore			30									30
71	Ekonomi dhe politika agrare			90									90
72	Financë-kontabilitet			100									100
73	Drejtim i ndërmarrjeve			20									20
74	Menaxhim financiar			20									20
75	Financë								70				70
76	Menaxhim agrobiznesi			60									60
77	Inxhinieri matematike		40										40
78	Inxhinieri fizike		40										40
79	Turizëm i qëndrueshëm					30							30
80	Mbrojtje mjediti					30							30
81	Matematikë e zbatuar					25							25
82	Studime të thelluara në gjuhësi						30						30
83	Studime letrare						30						30
84	Studime shqiptare dhe etnokulturore						30						30
85	Ekonomi												0
86	Ekonomi biznesi									30			30
87	Menaxhim									30			30
88	Financë banke									30			30
89	Politika dhe administrim									30			30
90	Marketing									30			30
91	Administrim publik									30			30
92	Master i Shkencave në drejtësi civile	100											100
93	Master i Shkencave në drejtësi penale	100											100
94	Master i Shkencave në drejtësi publike	100											100

95	E drejta Private e biznesit					30							30
96	E drejta Kushtetuese dhe Administrative					30							30
97	Arkeologji dhe Admin. i pasurive arkeologjike							35					35
98	Në fushën Financë me përqendrim	90											90
99	Në fushën Kontabilitet auditim	30											30
100	Në fushën Menaxhim turizëm	30											30
101	Në fushën Marketing	30											30
102	Në Fushën Sisteme informacioni në ekonomi	30											30
103	Në fushën Kërkime operacionale në menaxhim	30											30
104	Në fushën e Ekonomiksit	30											30
105	Në fushën e Administrim biznesi me përqendrim	60											60
106	Në fushën e Administrimit publik	30											30
107	Inxhinieri navale								120				120
108	Shkenca kompjuterike								40				40
109	Shkenca kompjutacionale								0				0
110	Shkenca sportive									31			31
111	Master Shkencor në real astate								70				70
112	Master në fushën e mbrojtjes										65		65
113	Studime gjuhësore												0
114	Studime letrare												0
115	Studime historike												0
116	Studime etnologjike												0
117	Studime arkeologjike												0
118	Legjislacioni dhe institucionet e BE	30											30
119	Politika dhe qeverisja në Europë	30											30
120	Diplomacia dhe Marrëdhëniet ndërkombëtare	30											30
121	Shuma	3713	790	600	166	210	40	35	500	180	31	65	6330

TABELA 2/1

TARIFAT VJETORE TË SHKOLLIMIT PËR STUDENTËT QË DO TË REGJISTROHEN NË
VITIN E PARË, PËR TË GJITHA PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË
“MASTER I SHKENCAVE”, NË VITIN AKADEMIK 2010-2011

a) Universiteti i Tiranës:	
I. Fakulteti i Shkencave të Natyrës:	
i) Fizikë	48.000 lekë
ii) Matematikë	48.000 lekë
iii) Të gjitha programet e tjera	67.200 lekë
II. Fakulteti i Gjuhëve të huaja:	57.600 lekë
III. Fakulteti Histori-Filologji	
i) Arkeologji	86.400 lekë
ii) Trashëgimi kulturore	86.400 lekë
iii) Të gjitha programet e tjera	57.600 lekë
IV. Fakulteti i Shkencave Sociale:	72.000 lekë
V. Fakulteti i Mjekësisë	240.000 lekë
VI. Fakulteti Ekonomik	80.000 lekë
VII. Fakulteti i Drejtësisë	60.000 lekë
VIII. Fakulteti i Infermierisë	240.000 lekë
IX. Instituti i Studimeve Europiane	80.000 lekë
b) Universiteti Politeknik i Tiranës:	
I. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit	72.000 lekë
II. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike	72.000 lekë
III. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	45.000 lekë
IV. Fakulteti i Gjeologji Miniera	40.000 lekë
V. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit	72.000 lekë
c) Universiteti Bujqësor i Tiranës:	
I. Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit	43.200 lekë
II. Fakultetin e Bioteknologjisë dhe Ushqimit	48.000 lekë
III. Fakultetin e Shkencave Pyjore	43.200 lekë
IV. Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit	57.600 lekë
d) Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë	48.000 lekë
e) Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër	55.000 lekë
f) Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës	55.000 lekë
g) Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër	48.000 lekë
k) Universiteti “F.S.Noli”, Korçë	48.000 lekë
l) Universiteti i Sporteve të Tiranës	95.000 lekë
m) Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan:	
i) Matematikë e zbatuar	48.000 lekë
ii) Të gjitha programet e tjera	60.000 lekë

VENDIM
Nr.903, datë 10.11.2010

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH, PËR SHPENZIME KAPITALE, NDËRMJET
PROGRAMEVE BRENDA BUXHETIT TË VITIT 2010, MIRATUAR PËR MINISTRINË E
MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 16 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve, për shpenzime kapitale, ndërmjet programeve brenda buxhetit të vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, si më poshtë vijon:

a) Në programin “Mbrojtje mjedisi” të shtohen fondet, përkatësisht për TVSH-në, në vlerën 9 720 500 (nëntë milionë e shtatëqind e njëzet mijë e pesëqind) lekë, dhe, për kosto lokale, në vlerën 7 579 500 (shtatë milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind) lekë.

b) Në programin “Administrimi i pyjeve” të pakësohen fondet, përkatësisht për TVSH-në, në vlerën 10 400 000 (dhjetë milionë e katërqind mijë) lekë dhe, për kosto lokale, në vlerën 6 900 000 (gjashhtë milionë e nëntëqind mijë) lekë.

2. Ngarkohen e Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.959, datë 24.11.2010

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT
TË KONTRATËS SË NËNSHKRUAR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT PUBLIK TË
KRYERA NGA MINISTRIA E BRENDSHME, SI AUTORITET KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të paragrafit të tretë të pikës 3/ç të kreut I të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Lejimin e Ministrisë së Brendshme, si autoritet kontraktor, të realizojë, brenda datës 20 dhjetor 2010, procedurat e prokurimit, për objektet e specifikuar në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Brenda këtij afati përfshihet edhe lidhja e kontratave përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Aneksi 1

Nr.	Autoriteti kontraktor	Fondi limit	Objekti i prokurimit	Shënim
1	Ministria e Brendshme	16 100 978	Blerje orendi dhe pajisje për mobilim zyre	Njoftim fituesi
2	Ministria e Brendshme	4 629 064	Blerje materiale të ndryshme për pastrim	Njoftim fituesi
3	Ministria e Brendshme	31 723 695	Blerje uniforma, veshmbathje dhe elemente të tjera përbërës të tyre	Njoftim fituesi
4	Ministria e Brendshme	32 885 548	Blerje pajisje elektronike dhe telekomunikacioni	Njoftim fituesi
5	Ministria e Brendshme	104 132 044	Blerje karburanti në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe institucioneve të varësisë	Njoftim fituesi
6	Ministria e Brendshme	77 990 629	Blerje pjesë ndërrimi për automjete për shërbimet profilaktike në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë	Njoftim fituesi
7	Ministria e Brendshme	32 429 167	Blerje pjesë ndërrimi për automjete për shërbimet profilaktike në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë	Njoftim fituesi
8	Ministria e Brendshme	21 059 442,90	Blerje letër në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë	Njoftim fituesi
9	Ministria e Brendshme	169 275 215	Shërbim pastrimi i ambienteve të brendshme të Komandës së Doktrinës dhe Stërviçjes	Njoftim fituesi
10	Ministria e Brendshme	5 517 000	Blerje këpucë	Njoftim fituesi
11	Ministria e Brendshme	133 921 981	Shërbim gatimi	Njoftim fituesi

VENDIM
Nr.960, datë 26.11.2010

PËR LEJIMIN E REALIZIMIT TË PROCEDURAVE DHE SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT E TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË KRYERA NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS, INSTITUCIONET NË VARËSI TË SAJ DHE NJËSITË E PUSHTETIT VENDOR, PËR PUNIMET E PROJEKTEVE TË REJA NË ARSIM, SI AUTORITETE KONTRAKTORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të paragrafit të tretë të pikës 3/ç të kreut I të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, të institucioneve në varësi të saj e të njëjseve të pushtetit vendor, si autoritete kontraktore, për punimet e projekteve të reja në arsim, të realizojnë, brenda datës 31 dhjetor 2010, procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe ndërtime, me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit, për vitin 2010, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Brenda këtij afati të përfshihen edhe lidhja e kontratave përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, institucionet në varësi të saj dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Aneksi 1

Nr.	Autoritet kontraktor	Objekti i prokurimit
1	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	Blerjen e pajisjeve elektronike të laboratorëve të informatikës për arsimin e mesëm profesional, me fondet e miratuara me vendimin nr.748, datë 15.9.2010 të Këshillit të Ministrave
2	Drejtoritë arsimore dhe zyrat arsimore	Blerja e librave artistikë për rikrijimin e fondit të bibliotekave për vitin shkollor 2010, në të gjitha drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore në rrethe
3	Drejtoritë arsimore dhe zyrat arsimore	Shërbimin e transportit të nxënësve e të mësuesve, në 13 drejtori rajonale arsimore dhe zyra arsimore
4	Drejtoritë arsimore dhe zyrat arsimore	Dokumentacionin shkollor (regjistrat dhe amzat), për vitin shkollor 2010-2011, në të gjitha drejtoritë e rajonale arsimore
5	Ministria e Arsimit dhe Shkencës Institucionet e arsimit të lartë	Blerjen e mallrave, shërbimeve, rikonstruksioneve dhe ndërtimit të objekteve në institucionet e arsimit të lartë, të cilat kanë si burim financimi fonde nga Buxheti i Shtetit, të ardhurat dytësore apo donatorët
6	Komuna Paskuqan	1. Rikonstruksion shkolle 9-vjeçare, Babrru-Qendër 2. Ndërtim shkolle 9-vjeçare + kopsht Babrru Kodër e Kuqe
7	Bashkia Kamëz	1. Rikonstruksion shkolle e bashkuar “Ibrahim Rugova” 2. Ndërtim kopsht i ri lagje “Bathore 6”, Bashkia Kamëz
8	Komuna Dajt	Ndërtim shkolle 9-vjeçare lagja Qesarakë
9	Komuna Lunik	Rikonstruksion shkolle e mesme “Faik Trungu” Zgosht
10	Komuna Guri i Zi	Ndërtim shkolle 9-vjeçare + kopsht Vukatanë
11	Komuna Topojë	Shtesë anësore + sistemim oborri shkolle 9-vjeçare e re Topojë

VENDIM
Nr.962, datë 24.11.2010

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR
PROCEDURAT E PROKURIMIT TË KRYERA NGA AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË
SË INFORMACIONIT, SI AUTORITET KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të paragrafit të tretë të pikës 3/ç të kreut I të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), si autoritet kontraktor, të përfundojë procedurat e prokurimit, me objekt “Rikonstruksioni i mjediseve të AKSHI-it (ish – ndërtesa e INIMA-s), për krijimin e “DATACENTER”, qendra e përqendruar e shërbimeve të qeverisë shqiptare”, me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit, për vitet 2010, 2011 e 2012, si dhe të nënshkruajë kontratën me ofertuesit fitues, brenda datës 30 dhjetor 2010.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.9/1, datë 15.11.2010

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.9, DATË 15.3.2010 “PËR PROCEDURAT DHE
AFATET E RISHPËRNDARJES SË BONOVE TË INVESTUARA NË FONDET E
INVESTIMEVE TË KRIJUARA NË PËRPTHJE ME LIGJIN NR.7979, DATË 26.7.1995
“PËR FONDET E INVESTIMEVE””**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të paragrafit të katërt të nenit 137 të ligjit nr.10 198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” dhe të nenit 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në pikën 2 të udhëzimit nr.9, datë 15.3.2010 “Për procedurat dhe afatet e rishpërndarjes së bonove të investuara në fondet e investimeve, të krijuara në përputhje me ligjin nr.7979, datë 26.7.1995 “Për fondet e investimeve”, bëhet ky ndryshim:

“2. Procesi i rishpërndarjes do të fillojë në datën 1 prill 2010 dhe do të mbyllet në 31.3.2011.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

URDHËR
Nr.9023, datë 1.11.2010

**PËR FORMËN, PËRMBAJTJEN DHE ADMINISTRIMIN E REGJISTRAVE TË NOTERËVE
DHE ASISTENTËVE, SI DHE PËR DOKUMENTACIONIN QË PËRMBAJNË DOSJET E
NOTERËVE E ASISTENTËVE**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7 pika 2 të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë” të ndryshuar, dhe të nenit 16, paragrafi 5 të ligjit nr.7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. “Noterët dhe asistentët regjistrohen në regjistrat, të cilët administrohen nga struktura përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë. Regjistrat e noterëve dhe asistentëve mbahen në dy forma:

- a) Në formën manuale (me shkrim);
- b) Në formën elektronike (digjitale).”

2. Regjistri manual dhe ai elektronik kanë të njëjtin format standard të miratuar me këtë urdhër. Elementet e veçanta që karakterizojnë regjistrin elektronik nuk përbëjnë shmangie nga forma standarde e regjistrit dhe lidhen vetëm me paraqitjen elektronike të të dhënave. Rregullat e plotësimit të regjistrit manual dhe atij elektronik janë të njëjta.

3. Regjistri manual përbëhet nga 100 fletë formati A3 të lidhura, numërtuara e vulosura në çdo faqe me vulën e Ministrisë së Drejtësisë. Çdo noteri apo asistenti i përket një faqe në regjistrin manual. Në raste të rralla, kur një faqe nuk është e mjaftueshme për të pasqyruar të dhënat e një noteri/asistenti, kalohet në faqen tjetër duke bërë shënimin përkatës në kolonën “shënime” të parashikuar në pikën 8 të këtij urdhri.

4. Në pjesën e pasme të faqes së fundit të çdo regjistri manual, punonjësi i strukturës përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë bën shënimin me shkrim dore:

“Ky regjistër përbëhet nga faqe të numërtuara e të vulosura, të cilat u kontrolluan e u sekretuan sot më datë (shënohet dita, muaji, viti, emri, mbiemri dhe nënshkrimi i punonjësit)”.

Në fund ky shënim vuloset me vulën e Ministrisë së Drejtësisë.

5. Kur një regjistër manual plotësohet, kalohet në regjistrin tjetër duke bërë shënimin në pjesën e pasme të faqes së fundit të regjistrit të plotësuar, si më poshtë:

“Ky regjistër u plotësua sot më datë (shënohet, dita, muaji, viti, emri, mbiemri, dhe nënshkrimi i punonjësit”).

Në fund, ky shënim vuloset me vulën e Ministrisë së Drejtësisë.

6. Kur hapet një regjistër i ri manual, në shënimin që bëhet në faqen e fundit sikurse parashikohet në pikën 5 shtohen edhe fjalët:

“Ky regjistër është vazhdim i regjistrit të plotësuar më datë (shënohet dita, muaji, viti, emri, mbiemri dhe nënshkrimi i punonjësit).”

7. Numri i regjistrave manualë përcaktohet në bazë të numrit total të noterëve dhe asistentëve. Në rast se hapen dy e më shumë regjistra të noterëve/asistentëve, këta regjistra mund të numërohen në faqen e parë të tyre. Numërtimi bëhet nga punonjësi i strukturës përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë.

8. Çdo faqe e regjistrave në krye emërtohet sipas rastit “Regjistër i Noterëve” ose “Regjistri i Asistentëve”. Çdo faqe është e ndarë në 30 rreshta, si dhe kolona të emërtuara si më poshtë:

a) kolonat e regjistrit të noterëve:

- Numri i dosjes personale si noter;

- Emri, atësia, mbiemri, fotografia (e kohës së regjistrimit);

- Datëlindja (dita, muaji, viti i lindjes);

- Diplomimi (viti i diplomimit, numri i diplomës, lloji i diplomës, referuar ligjit “Për arsimin e lartë”);

- Periudha si asistent noter (data e fillimit dhe data e mbarimit të veprimtarisë së asistentit, noteri pranë të cilit ka qëndruar, si dhe puna e kryer përpara dhënies së licencës në rast se është përjashtuar nga detyrimi për të punuar si asistent, në përputhje me ligjin “Për noterinë”);

- Numri dhe data e licencës;

- Dhoma e noterisë (në nivel lokal, anëtar i së cilës është noteri);
 - Vendndodhja e zyrës noteriale (adresa e saktë);
 - Adresa e vendbanimit dhe numri i kontaktit (numër telefoni);
 - Transferimi i noterit (nr. dhe data e urdhrimit të Ministrit të Drejtësisë për transferimin e noterit dhe dhoma në nivel lokal ku ai transferohet);
 - Masa disiplinore (nr. dhe data e urdhrimit të Ministrit të Drejtësisë për dhënien e masës, lloji i masës, koha kur është ekzekutuar dhe/ose kur është parashikuar në përputhje me kushtet e përcaktuara në ligjin “Për noterinë”);
 - Heqja e licencës së ushtrimit të profesionit (nr. dhe data e urdhrimit të Ministrit të Drejtësisë për heqjen e licencës, si dhe arsyeja e heqjes në përputhje me ligjin “Për noterinë”);
 - Arkivi noterial (nr. dhe data e urdhrimit të Ministrit të Drejtësisë për dorëzimin e arkivit noterial, data e procesverbalit të dorëzimit, emri dhe mbiemri i noterit së cilit i dorëzohet);
 - Marrja e vulave dhe/ose asgjësimi (nr. dhe data e urdhrimit të Ministrit të Drejtësisë për marrjen e përkohshme ose përfundimtare të vulës dhe data e asgjësimit të vulës);
 - Shënime (pasqyrohen të dhënat që nuk përfshihen në rubrikat e tjera dhe që çmohen se janë të rëndësishme për t’u pasqyruar, p.sh. kalimi në faqe tjetër, si rast përjashtimor, për efekt plotësimi, pasqyrohet shkurt arsyeja e shënimeve ose e ndryshimeve në të dhënat e regjistrimit, si dhe data, muaji, viti, emri, mbiemri e nënshkrimi i personit që ka bërë shënime).
- b) Kolonat e regjistrimit të asistentëve:
- Numri i dosjes personale si asistent;
 - Emri, atësia, mbiemri, fotografia (e kohës së regjistrimit);
 - Datëlindja (dita, muaji, viti i lindjes);
 - Diplomimi (viti i diplomimit, numri i diplomës, lloji i diplomës, referuar ligjit “Për arsimin e lartë”);
 - Numri dhe data e aktit të miratimit (shënohen të dhëna mbi numrin, ditën, muajin e vitin e aktit të miratimit si asistent);
 - Dhoma e noterisë dhe noteri pranë të cilit qëndron si asistent (dhoma e noterisë në nivel lokal, anëtar i së cilës është noteri pranë të cilit qëndron si asistent, si dhe emri dhe mbiemri i noterit pranë të cilit qëndron si asistent);
 - Periudha si asistent (data e fillimit, mbarimit, dhe zgjatja ose ndërprerja e afatit si asistent);
 - Masa disiplinore (nr. dhe data e urdhrimit të Ministrit të Drejtësisë për dhënien e masës, lloji i masës, si dhe koha kur ajo është ekzekutuar ose është parashikuar);
 - Shënime (pasqyrohen të dhënat që nuk përfshihen në rubrikat e tjera dhe që çmohen se janë të rëndësishme për t’u pasqyruar, p.sh. kalimi në faqe tjetër, si rast përjashtimor, për efekt plotësimi, pasqyrohet shkurt arsyeja e shënimeve ose e ndryshimeve në të dhënat e regjistrimit, si dhe data, muaji, viti, emri, mbiemri e nënshkrimi i personit që ka bërë shënime).
- Modelet e regjistrave të noterëve dhe asistentëve (manualë dhe elektronikë) paraqiten përkatësisht në shtojcat nr.1 dhe nr.2, bashkëlidhur këtij urdhri.

9. Regjistrat administrohen nga struktura përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë dhe plotësohen me të dhënat e nevojshme, në sistemin elektronik ose me shkrim dore në regjistrin manual, prej personit të ngarkuar.

10. Në rast se bëhen gabime në hedhjen e informacionit në regjistrin manual, fjala e shkruar gabim nuk fshihet, por i vihet një vizë në mes në të gjithë gjatësinë e saj dhe futet në kllapa, duke vijuar të shkruhet informacioni i saktë.

Në rast se bëhen gabime në regjistrin elektronik dhe ato nuk korrigjohen në çast, por në një moment të dytë pasi është saktësuar informacioni nëpërmjet dokumentacionit apo të dhënave përkatëse, korrigjimi i bërë pasqyrohet në mënyrë të tillë që krahas tij të shfaqet elektronikisht edhe data, muaji, viti, emri, mbiemri i personit që ka bërë korrigjimin.

11. Për çdo noter dhe asistent, në arkivin e Ministrisë së Drejtësisë, mbahet dosja personale, e cila krijohet dhe pasurohet me dokumentacionin e nevojshëm nga struktura përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë. Dosja personale e noterit/asistentit numërtohet në përputhje me numrin rendor që i korrespondon noterit/asistentit në regjistrin aktual të administruar nga strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë.

12. Dokumentacioni i ndodhur në dosje, i cili pasqyron në mënyrë kronologjike të gjithë procesin e ndjekur nga asistenti dhe noteri në përputhje me legjislacionin në fuqi, numërtohet dhe

pasqyrohet në fletën e pasqyrës së dokumenteve të dosjes të ngjitur në pjesën e brendshme të kapakut të saj ose të bashkëlidhur në kapak me vulën e Ministrisë së Drejtësisë.

13. Fleta e pasqyrës së dokumenteve të dosjes të jetë fletë, format A4 e emërtuar “Pasqyra e dokumenteve në dosjen e noterit/asistentit (emër, mbiemër)”, sipas modelit të paraqitur në shtojcën nr.3 bashkëlidhur këtij urdhri.

Kolonat kanë emërtimet e mëposhtme:

- a) Nr.(numri rendor i dokumentit);
- b) Emri i dokumentit dhe i lëshuesit (institucionit apo personit);
- c) Nr.i faqeve;
- ç) Data/numri i protokollit (data e lëshimit dhe nëse ka numri i protokollit të lëshuesit);
- d) Data, emri dhe nënshkrimi i administruesit (data e vendosjes në dosje dhe emri e nënshkrimi i personit që e vendosi dokumentin në dosje dhe bëri shënimet në fletën e pasqyrës së dokumenteve të dosjes).

14. Dosja e asistentit të përmbajë dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Fotokopjen e noterizuar të dokumentit të identifikimit (pasaportë apo letërnjoftim ID);
- b) Vërtetimin nga organet e pushtetit vendor lidhur me vendbanimin;
- c) Fotokopjen e noterizuar të diplomës së Fakultetit të Drejtësisë dhe të certifikatës së notave;
- ç) Formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore, i plotësuar;
- d) Vërtetimin nga gjykata dhe prokuroria e vendbanimit se nuk është subjekt në proces për vepra penale;
- dh) Nëse ka qenë në marrëdhënie pune në institucione shtetërore, referencën nga punëdhënësit e tre vjetëve të fundit, si dhe shpjegimet e tyre mbi arsyet e largimit nga puna;
- e) Fotokopjen e noterizuar të librezës së punës (kur ka qenë punëmarrës);
- ë) Kopjen e kontratës të lidhur mes tij dhe noterit pranë të cilit do të qëndrojë si asistent;
- f) Kopjen e aktit të miratimit si asistent;
- g) Referencën e lëshuar nga noteri, për periudhën e qëndrimit si asistent;
- gj) Certifikatën e Dhomës Kombëtare të Noterisë (kur është dhënë e tillë);
- h) Kur është rasti, njoftime të ndryshme nga noteri, dokumente që pasqyrojnë arsye të ndërprerjes e shtyrjes së periudhës së qëndrimit si asistent ose marrjen e masave disiplinore ndaj asistentit etj.

Për asistentët që janë miratuar përpara hyrjes në fuqi të urdhrit nr.8047, datë 2.12.2004 dosja të përmbajë dokumentet e mësipërme, përveç atyre që nuk mund të merren për shkak se ka kaluar koha e marrjes së tyre dhe nuk kanë qenë parashikuar në legjislacionin në fuqi në kohën kur janë miratuar si asistentë.

15. Kur personit që ka përfunduar periudhën e asistencës i është dhënë licenca për ushtrimin e profesionit të noterit, dosja e tij si asistent të jetë e njëjta edhe për noter, por me emërtimin si noter dhe të numërohet me numrin rendor që noteri do të ketë në regjistrin e noterëve. Dosjes si noter, krahas dokumenteve që përmban dosja si asistent t’i shtohen edhe dokumentet e mëposhtme:

- a) Urdhri i Ministrisë së Drejtësisë për dhënien e licencës së ushtrimit të profesionit (nr. dhe data e urdhrit);
- b) Formulari i vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore, i plotësuar;
- c) Vërtetimi nga dhoma e noterisë në nivel vendor se është pranuar anëtar i kësaj dhome;
- ç) Fotokopja e noterizuar e certifikatës së regjistrimit si person fizik;
- d) Fotokopja e noterizuar e certifikatës së regjistrimit në organin tatimor;
- dh) Modeli i vulës dhe i nënshkrimit;
- e) Kur është rasti, dokumente që pasqyrojnë transferime ose veprime të tjera (ndërprerje për shkak sëmundjeje ose shtatzënie etj.);
- ë) Kur është rasti kopje e dokumenteve që pasqyrojnë masat disiplinore të dhëna;
- f) Kopje të vendimeve të gjykatave për rastet kur janë kundërshtuar masat disiplinore.

16. Kur licenca e ushtrimit të profesionit të noterit i është dhënë një personi të cilin ligji e ka përjashtuar nga detyrimi për të qëndruar si asistent, dosja e tij të përmbajë dokumentet e mëposhtme:

- a) Fotokopjen e noterizuar të dokumentit të identifikimit (pasaportë apo letërnjoftim ID);
- b) Fotokopjen e diplomës së fakultetit të drejtësisë dhe të certifikatës së notave të noterizuar;
- c) Formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të plotësuar;

c) Vërtetimet nga gjykata e shkallës së parë dhe prokuroria pranë saj se nuk është subjekt i proceseve për kryerje të veprave penale;

d) Vërtetimin nga punëdhënësit e tre vjetëve të fundit se nuk është larguar nga puna për shkelje disiplinore (kur ka qenë punëmarrës);

dh) Vërtetimin nga Dhoma Kombëtare e Noterisë ose Avokatisë se nuk është marrë masë disiplinore ndaj tij (në rastin kur brenda 2 vjetëve të fundit ka ushtruar një nga këto profesione);

e) Fotokopjen e noterizuar të librezës së punës (kur ka qenë punëmarrës);

ë) Urdhri i Ministrit të Drejtësisë për dhënien të licencës së ushtrimit të profesionit (nr. dhe data e urdhrimit);

f) Vërtetimin nga dhoma e noterisë në nivel lokal se është pranuar anëtar i kësaj dhome;

g) Fotokopjen e noterizuar të certifikatës së regjistrimit si person fizik;

gj) Fotokopjen e noterizuar të certifikatës së regjistrimit në organin tatimor;

h) Modelin e vulës dhe të nënshkrimit;

i) Kur është rasti, dokumente që pasqyrojnë transferime ose veprime të tjera (ndërprerje për shkak sëmundjeje ose shtatzënie, procesverbale për asgjësim vule etj.);

j) Kopje të dokumenteve që pasqyrojnë masat disiplinore të dhëna (nëse janë dhënë të tilla);

k) Kopje të vendimeve të gjykatave për rastet kur janë kundërshtuar masat disiplinore.

17. Dosja e noterit të cilit i është dhënë licenca e ushtrimit të profesionit përpara hyrjes në fuqi të këtij urdhri të përmbajë detyrimisht dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Fotokopjen e noterizuar të dokumentit të identifikimit (pasaportë apo letërnjoftim ID);

b) Fotokopjen e noterizuar të diplomës së Fakultetit të Drejtësisë dhe certifikatës së notave;

c) Formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore, të plotësuar;

ç) Kopje të urdhrimit të Ministrit për dhënien e licencës së ushtrimit të profesionit;

d) Kur ka qenë asistent, një vërtetim nga dhoma e noterisë, anëtar i së cilës ka qenë noteri pranë të cilit ka qëndruar si asistent;

dh) Vërtetimin nga dhoma e noterisë që mbulon vendin ku ushtrojnë profesionin, se janë anëtarë të saj;

e) Fotokopjen e noterizuar të certifikatës së regjistrimit si person fizik;

ë) Fotokopje të certifikatës së regjistrimit në organin tatimor;

f) Modelin e vulës dhe të nënshkrimit;

g) Kur është rasti, dokumente që pasqyrojnë transferime ose veprime të tjera (ndërprerje për shkak sëmundjeje ose shtatzënie procesverbale për prishje vule etj.);

gj) Kopje të dokumenteve që pasqyrojnë masat disiplinore të dhëna (ose janë dhënë të tilla);

h) Kopje të vendimeve të gjykatave për rastet kur janë kundërshtuar masat disiplinore.

18. Numërtimi dhe plotësimi i dosjeve të noterëve/asistentëve sipas parashikimeve të mësipërme të bëhet brenda 6 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.

Brenda 30 ditësh nga marrja e kërkesës së bërë nga struktura përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë, noteri paraqet dokumentacionin e kërkuar për plotësimin e dosjes personale.

Mosrespektimi i këtij detyrimi nga noteri të shoqërohet me dhënien e masës disiplinore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

19. Urdhri nr.8047, datë 2.12.2004 “Për formën, përmbajtjen dhe administrimin e regjistrave të noterëve dhe asistentëve, si dhe për dokumentacionin që përmbajnë dosjet e noterëve e asistentëve” shfuqizohet.

20. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË

Bujar Nishani

Shtojca 1

MODELI I REGJISTRIT TË NOTERËVE

Nr.dosjes	Emri,atësia,mbiemri (Foto)	Datëlindja			Diplomimi		Periudha si asistent noter			Licenca		Dhoma e noterisë	Vendndodhja e zyrës noteriale	Adresa e vendbanimit dhe numri i kontaktit	Transferimi i noterit		Masa disiplinore				Heqja e licencës		Arkivi noterial			Marrja e vulave dhe/ose asgjësimi			Shënime								
		Dita	Muaji	Viti	Viti	Numri	Lloji	Data e fillimit	Data e mbarimit	Emri,mbiemri i noterit ku ka qëndruar si asistent	Arsyja e përjashtimit nga detyrimi për të punuar si asistent (Funksioni)				Numri	Data	Nr./Datë, Urdhër Ministri për transferim	Dhoma lokale ku transferohet	Nr./Datë,Urdhër Ministri	Lloji i masës	Koha e ekzekutimit	Koha e parashikimit	Nr./Datë Urdhër Ministri	Arsyja	Nr./Datë, Urdhër Ministri për dorëzimin e arkivit procesverbalit të dorëzimit	Data e processverbalit të dorëzimit	Emri,mbiemri i noterit të cilit i dorëzohet	Nr./Datë,Urdhër Ministri për marrjen e perkohshme të vulës		Nr./Datë,Urdhër Ministri për marrjen përfundimtare të vulës	Data e asgjësimit						

Shtojca 2

MODELI I REGJISTRIT TË ASISTENTËVE

Nr.dosjes	Emri,atësia,mbiemri (Foto)	Datëlindja				Diplomimi				Numri dhe data e aktit të miratimit si asistent				Dhoma e noterisë dhe noteri ku qëndron si asistent		Periodha si Asistent			Masa disiplinore			Shënime				
		Dita	Muaji	Viti	Viti	Numri	Lloji	Me ose pa shkëputje nga puna dhe universiteti	Nr.akti	Dita	Muaji	Viti	Dhoma lokale anëtar i së cilës është noteri	Emri, mbiemri i noterit	Data e fillimit	Data e mbarimit	Zgjatja ose ndërprerja e fatit si asistent	Nr./Datë, Urdhër Ministri	Lloji i masës	Koha e ekzekutimit	Koha e parashkrimit					

Shtojca 3

PASQYRA E DOKUMENTEVE QË PËRMBAN DOSJA E NOTERIT/ASISTENTIT

Nr.rendor i dokumentit	Emri i dokumentit dhe lëshuesi			Nr. i faqeve	Data/Numri i protokollit		Data, emri dhe nënshkrimi i administruesit	
	Emri i dokumentit	Lëshuesi			Data e lëshimit	Nr.Protokollit	Data e vendosjes në dosje	Emri e nënshkrimi i personit
		Institucioni	Personi					

KËRKESË

Nr.3723/4, datë 15.11.2010

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të kulturave bujqësore dhe drufrutorë, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Levan-Vlorë (seksioni i dytë).

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtorja e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Pronari i pasurisë për të cilën është bërë shënimi “Bllokuar për arsye verifikimi nga Komisioni i Verifikimit të Titujve të Pronësisë”, do të kompensohet për efekt shpronësimi pasi të përfundojnë procedurat përkatëse të verifikimit dhe të jepet konfirmim zyrtar nga Komisioni i Verifikimit të Titujve të Pronësisë dhe më pas nga ZVRRPP-ja Vlorë lidhur me titullin e pronësisë.

Pronarët e pasurive për të cilat në kolonën respektive është bërë shënimi “të pasaktësuara”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pasi të kenë bërë regjistrimet përkatëse pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Vlorë dhe pasi të jenë konfirmuar të dhënat e plota dhe të sakta po nga kjo zyrë lidhur me titullin e pronësisë.

Pronarët e pasurive për të cilat në kolonën respektive është bërë shënimi “Proces regjistrimi”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas përfundimit të këtij procesi dhe pasi të jetë dhënë konfirmimi zyrtar nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Vlorë, si dhe në bazë të dokumentacionit të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

Pronarët e pasurive për të cilat në kolonën respektive është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 21 655 392 (njëzet e një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e treqind e nëntëdhjetë e dy) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE
FSHATI ALIBAN

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA SEGMENTI RRUGOR LEVAN - VLORË
PËR KULTURAT BUJQËSORE DHE DRUFRUTORE

Nr.	Emri	Mbiemri	Z/Kad.	Nr.Pas.	Nga kjo/Sip. e mbjellë	Bimë arash/Vlera lekë	Shënime
1	Nikolla	Doko	1012	3/18	806	9672	Konfirmuar nga ZRPP
2	Pandeli	Doko	1012	3/19	911	10932	Konfirmuar nga ZRPP
3	Zoji	Doko	1012	3/21	927	11124	Konfirmuar nga ZRPP
4	Leonidha	Doko	1012	3/23	1154	13848	Konfirmuar nga ZRPP
5	Pilo	Greku	1012	122/5	1730	27680	Konfirmuar nga ZRPP
6	Irakli	Greku	1012	122/4	877	14032	Konfirmuar nga ZRPP
7	Theodhori	Greku	1012	122/11	701	11216	Konfirmuar nga ZRPP
8	Llaqi	Greku	1012	122/7	860	6880	Konfirmuar nga ZRPP
9	Jorgji	Milo	1012	122/15	1495	23920	Konfirmuar nga ZRPP
10	Llazi	Milo	1012	122/16	722	8664	Konfirmuar nga ZRPP
11	Sena	Milo	1012	122/17	2220	26640	Konfirmuar nga ZRPP
12	Agron	Doko	1012	3/17	504	6048	Konfirmuar nga ZRPP
13	Minella	Doko	1012	3/22	832	13312	Konfirmuar nga ZRPP
14	Minella	Qarri	1012	3/6	839	10680	Konfirmuar nga ZRPP
15	Dhori	Qarri	1012	3/16	993	15888	Konfirmuar nga ZRPP
16	Harilla	Qarri	1012	3/8	2222	35552	Konfirmuar nga ZRPP
17	Qirjaq	Qarri	1012	3/10	832	9984	Konfirmuar nga ZRPP
18	Filip	Greku	1012	122/9	851	13616	Konfirmuar nga ZRPP
19	Petraq	Qarri	1012	3/5	1053	16848	Konfirmuar nga ZRPP
20	Spiro	Qarri	1012	3/2	650	10400	Konfirmuar nga ZRPP
21	Pali	Greku	1012	122/10	1008	16128	Konfirmuar nga ZRPP
22	Pëllumb	Ofiqi	1012	3/1	3330	53280	Konfirmuar nga ZRPP
23	Thanas	Doko	1012	3/20	816	13056	Konfirmuar nga ZRPP
24	Andon	Qarri	1012	3/3	896	14336	Konfirmuar nga ZRPP
25	Vangjel	Qarri	1012	3/4	1012	16192	Konfirmuar nga ZRPP
26	Kozma	Qarri	1012	3/7	1342	16104	Konfirmuar nga ZRPP
27	Andrea	Qarri	1012	3/9	681	8172	Konfirmuar nga ZRPP
28	Thoma	Qarri	1012	3/11	759	12144	Konfirmuar nga ZRPP
29	Jorgji	Qarri	1012	3/13	753	12048	Konfirmuar nga ZRPP
30	Niso	Qarri	1012	3/12	937	11244	Konfirmuar nga ZRPP
31	Tasi	Greku	1012	122/3	903	14448	Konfirmuar nga ZRPP
32	Pandi	Greku	1012	122/8	726	11616	Konfirmuar nga ZRPP
33	Themi	Milo	1012	122/20,122/14	3574	57184	Konfirmuar nga ZRPP
34	Rrapush	Milo	1012	122/18	3523	42276	Konfirmuar nga ZRPP
35	Vasil	Greku	1012	122/13	798	12768	Konfirmuar nga ZRPP
36	Pali	Mocka	1012	122/1	4462	71392	Blokuar për arsye verifikimi nga Komisioni i Verifikimit të Titujve të Pronësisë
37	Andon	Greku	1012	122/2	1016	16256	Konfirmuar nga ZRPP
	TOTALI					695580	

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
"LEVAN - VLORË" PËR KULTURAT BUJQËSORE DHE DRUFRTORË
QARKU: VLORË KOMUNA: NOVOSELË: FSHATI: FITORE

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr.Pas.	Nga kjo/Sip. e mbjellë	Bimë arash/Vlera lekë	Shënime
1	Halil		Balili	1625	20/48	599	9584	Konfirmuar nga ZRPP
2	Arif		Ferko	1625	19/3	1073	13116	Konfirmuar nga ZRPP
3	Bujar		Troka	1625	42/7	852	10224	Konfirmuar nga ZRPP
4	Bledar		Troka	1625	42/4	1091	13092	Konfirmuar nga ZRPP
5	Gëzim		Troka	1625	42/8	317	3804	Konfirmuar nga ZRPP
6	Ylli		Troka	1625	42/11	552	6624	Konfirmuar nga ZRPP
7	Kadri		Troka	1625	42/5	614	7368	Konfirmuar nga ZRPP
8	Pëllumb		Troka	1625	42/13	1319	15828	Konfirmuar nga ZRPP
9	Zylfi		Arapi	1625	19/16	646	5168	Konfirmuar nga ZRPP
10	Fatmir		Arapi	1625	19/19	76	1216	Konfirmuar nga ZRPP
11	Selman		Bodo	1625	42/15	396	4752	Konfirmuar nga ZRPP
12	Astrit		Arapi	1625	43/28	2000	32000	Konfirmuar nga ZRPP
13	Xhafo		Ferko	1625	19/94	500	6000	Konfirmuar nga ZRPP
14	Dallëndyshe		Arapi	1625	43/26	24	384	Konfirmuar nga ZRPP
		TOTALI					129160	

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
"LEVAN - VLORË" PËR KULTURAT BUJQËSORE DHE DRUFRTORË
QARKU: VLORË KOMUNA: QENDËR FSHATI: PANAJA

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Z/Kad.	Nr.Pas.	Nga kjo/Sip. e mbjellë	Dru frutor/Vlera lekë	Shënime
1	Qenan		Hoxha	2870	31/1	1044	165996	Konfirmim nga ZRPP
2	Lavdosh		Lulaj	2870	15/11	2174	345666	Konfirmim nga ZRPP
3	Neki		Metaj	2870	15/9	1946	309414	Konfirmim nga ZRPP
4	Nestor		Metaj	2870	15/8	2680	426120	Konfirmim nga ZRPP
5	Valter		Bendaj	2870	2/6	658	104622	Konfirmim nga ZRPP
6	Shyqo		Bendaj	2870	102/1	390	73010	Konfirmim nga ZRPP
7	Zyber		Alliraj	2870	6/21,6/9	674	107166	Konfirmim nga ZRPP
8	Luftar		Bendaj	2870	6/20	533	87927	Konfirmim nga ZRPP
9	Luto		Bani	2870	6/17	536	85224	Konfirmim nga ZRPP
10	Sabri		Llaci	2870	34/17	2253	358227	Konfirmim nga ZRPP
11	Lavdosh		Bregu	2870	34/39	485	77115	Konfirmim nga ZRPP
12	Vexhi		Hoxha	2870	31/10	649	103191	Konfirmim nga ZRPP
13	Ismail		Bejaj	2870	31/6	613	97467	Konfirmim nga ZRPP
14	Myrteza		Hoxha	2870	31/5	1877	298443	Konfirmim nga ZRPP
15	Osmen		Bendaj	2870	6/14,2/9	925	147075	Konfirmim nga ZRPP
16	Mynyr		Hoxha	2870	31/9	984	156456	Konfirmim nga ZRPP
17	Merdali		Bendaj	2870	2/10	650	103350	Konfirmim nga ZRPP
18	Kudret		Alliu	2870	34/30	1079	171561	Konfirmim nga ZRPP
19	Petrit		Alliu	2870	34/31	670	106530	Konfirmim nga ZRPP
20	Edmond		Alliu	2870	34/33	861	136899	Konfirmim nga ZRPP
21	Qemal		Alliu	2870	34/32	594	94446	Proces regjistrimi
22	Zini		Hoxha	2870	31/11	446	70914	Konfirmim nga ZRPP
23	Idai		Hoxha	2870	31/12	601	95559	Konfirmim nga ZRPP
24	Luan		Kafili	2870	34/7	1267	150000	Konfirmim nga ZRPP
25	Taulant		Bani	2870	6/16	641	101919	Konfirmim nga ZRPP

26	Viron		Hoxha	2870	15/15	240	38160	Konfirmim nga ZRPP
27	Dervish		Hoxha	2870	32/10	300	46587	Konfirmim nga ZRPP
28	Behar		Hoxha	2870	15/5	570	90630	Konfirmim nga ZRPP
29	Agim		Hoxha	2870	15/6	963	153117	Konfirmim nga ZRPP
30	Ilirjan		Hoxha	2870	15/3	830	131970	Konfirmim nga ZRPP
31	Halit		Hoxha	2870	31/4	2226	353934	Konfirmim nga ZRPP
32	Fejzo		Bejaj	2870	31/8	667	106053	Konfirmim nga ZRPP
33	Jaup		Bendaj	2870	2/8	546	86814	Konfirmim nga ZRPP
34	Luan		Bendaj	2870	6/44	668	106212	Konfirmim nga ZRPP
35	Xhyher		Bendaj	2870	102/2	1702	283118	Konfirmim nga ZRPP
36	Panajot		Profka	2870	102/5	1615	256785	Konfirmim nga ZRPP
37	Naim		Hoxha	2870	31/17	800	127200	Konfirmim nga ZRPP
38	Tomorr		Hoxha	2870	15/4	933	188670	Konfirmim nga ZRPP
39	Beniamin	Fejzo	Bejaj	2870	31/7	389	61851	Konfirmim nga ZRPP
40	Gjon		Hoxha	2870	31/14	522	82998	Konfirmim nga ZRPP
41	Kujtim		Hoxha	2870	31/13	663	105417	Konfirmim nga ZRPP
42	Myftar		Bani	2870	6/37	643	102237	Konfirmim nga ZRPP
43	Sami		Hoxha	2870	31/15	162	25768	Proces regjistrimi
		TOTALI					6321818	

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
"LEVAN - VLORË" PËR KULTURAT BUJQËSORE DHE DRUFRRUTORË
QARKU: VLORË KOMUNA: NOVOSELË FSHATI: BISHAN

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr.Pas	Nga kjo/Sip. e mbjellë	Bimë arash/Vlera lekë	Dru frutor/Vlera lekë	Totali lekë	Shënime
1	Koci		Llanaj	1191	20/10,19/3	1343	16116		16116	Konfirmim nga ZRPP
2	Syrja		Llanaj	1191	23/8	742	11872		11872	Konfirmim nga ZRPP
3	Sihat		Llanaj	1191	23/7	871		268500	268500	Konfirmim nga ZRPP
4	Barjam		Llanaj	1191	3/1,23/5	3925	62800		62800	Konfirmim nga ZRPP
5	Qani		Peshtani	1191	16/9	1115	13380		13380	Konfirmim nga ZRPP
6	Mehmet		Peshtani	1191	16/10	532	6348		6348	Konfirmim nga ZRPP
7	Asqeri		Llanaj	1191	19/2	1987	31792		31792	Konfirmim nga ZRPP
8	Hader		Llanaj	1191	19/1	3840	61440		61440	Konfirmim nga ZRPP
9	Arjanit		Aliaj	1191	21/12	547	8752		8752	Konfirmim nga ZRPP
10	Gudar		Tojalli	1191	21/20	371	5936		5936	Konfirmim nga ZRPP
11	Lulzim		Tojalli	1191	21/21	95	1520		1520	Konfirmim nga ZRPP
12	Naim		Bulla	1191	21/39	1926	30816		30816	Konfirmim nga ZRPP
13	Ramiz		Tojalli	1191	21/18	772	12352		12352	Konfirmim nga ZRPP
14	Them		Tojalli	1191	21/17	1700	27200		27200	Konfirmim nga ZRPP
15	Pajtim		Tojalli	1191	21/38	1525	18300		18300	Konfirmim nga ZRPP
16	Artur		Toja	1191	21/37	243	2916		2916	Konfirmim nga ZRPP
17	Iljaz		Llanaj	1191	23/11	633		126040	126040	Konfirmim nga ZRPP
18	Hader		Llanaj	1191	20/8	1115		185450	185450	Konfirmim nga ZRPP
19	Zaim		Llanaj	1191	23/13	186		39310	39310	Konfirmim nga ZRPP
20	Rrushdi		Llanaj	1191	20/4,16/17	981		188600	188600	Proces regjistrimi
21	Asqeri		Llanaj	1191	20/9	1081		252500	252500	Konfirmim nga ZRPP
22	Haredin		Llanaj	1191	20/5	590		81040	81040	Konfirmim nga ZRPP
23	Ramazan		Llanaj	1191	23/6	925		147075	147075	Konfirmim nga ZRPP
24	Axhem		Llanaj	1191	20/6	1033		293400	293400	Konfirmim nga ZRPP
25	Selim		Llanaj	1191	23/9	757		154180	154180	Konfirmim nga ZRPP
26	Hekuran		Cepele	1191	16/13,23/2	611		139000	139000	Konfirmim nga ZRPP
27	Jonuz		Gjodeshi	1191	23/4	1606		344000	344000	Konfirmim nga ZRPP
28	Durim		Murati	1191	16/8	759		390000	390000	Konfirmim nga ZRPP
29	Xhyher		Llanaj	1191	20/7	1224		273640	273640	Konfirmim nga ZRPP
30	Lavdim		Cepele	1191	23/3	668		293480	293480	Konfirmim nga ZRPP
31	Fetah	Hysni	LLanaj	1191	22/11	2767		252050	252050	Konfirmim nga ZRPP
32	Lavderim		Metushi	1191	21/44	1124		56700	56700	Konfirmim nga ZRPP
33	Sami		Aliaj	1191	21/13	827	13232		13232	Konfirmim nga ZRPP
34	Pelivan		Metushi	1191	21/42	1283	15396		15396	Konfirmim nga ZRPP

35	Agim		Aliaj	1191	21/11	844	13504		13504	Konfirmim nga ZRPP
36	Lutfi		Tojalli	1191	21/15	1654	19848		19848	Konfirmim nga ZRPP
37	Agron		Aliaj	1191	21/5	1254	15048	44000	59048	Konfirmim nga ZRPP
38	Namik		Aliaj	1191	21/6	1548	18756		18756	Konfirmim nga ZRPP
39	Xhemil		Aliaj	1191	21/7	2143	25716		25716	Konfirmim nga ZRPP
40	Toto		Aliaj	1191	21/9	1140	18240		18240	Konfirmim nga ZRPP
41	Guri		Aliaj	1191	21/8	1246	19936		19936	Konfirmim nga ZRPP
42	Hysni		Bulla	1191	69/14	1326	10608		10608	Konfirmim nga ZRPP
43	Novruz		Bulla	1191	69/23	1873	14984		14984	Konfirmim nga ZRPP
44	Bardhosh		Bulla	1191	69/10	1534	12272		12272	Konfirmim nga ZRPP
45	Xhevahir		Murati	1191	16/7	528		155000	155000	Konfirmim nga ZRPP
		Shuma					509080	3683965	4193045	

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
"LEVAN - VLORË" PËR KULTURAT BUJQËSORE DHE DRUFRUTORË
QARKU :VLORË, KOMUNA: QENDËR, FSHATI: NARTË

Nr.	Emri	Mbiemri	Z.Kad.	Nr.Pasurisë	Sip.e mbjellë drufrutor	Vlera lekë drufrutor	Shënime
1	Luiza	Berberi	2765	132/5/1	1608	104000	Proces regjistrimi
2	Patra	Zarka	2765	132/5/2	1090	123500	Proces regjistrimi
3	Ilia	Andrea	2765	132/5/4	1572	130000	Proces regjistrimi
4	Lloji	Andrea	2765	132/5/5	2705	175500	Proces regjistrimi
5	Sotir	Baka	2765	132/5/8	667	52000	Proces regjistrimi
6	Aleko	Konomi	2765	132/5/9	1363	130000	Proces regjistrimi
7	Filip	Thanasko	2765	132/5/10	1557	143000	Proces regjistrimi
8	Grigor	Xamaxa	2765	132/5/11	1285	130000	Proces regjistrimi
9	Pandeli	Shteto	2765	132/5/12	1268	104000	Proces regjistrimi
10	Filip	Backa	2765	132/5/13	1406	91000	Proces regjistrimi
11	Telemak	Karavoqiri	2765	132/5/15	1509	182000	Proces regjistrimi
12	Jorgji	Skarco	2765	132/1/3	1271	162500	Proces regjistrimi
13	Vllas	Ceko	2765	132/1/6	359	32500	Proces regjistrimi
14	Nasho	Papa	2765	132/1/11	1104	78000	Proces regjistrimi
15	Grigor	Papa	2765	132/1/10	563	78000	Proces regjistrimi
16	Vasil	Seva	2765	132/1/14	162	26000	Proces regjistrimi
17	Theodhoraq	Xhaxho	2765	132/1/8	2094	162500	Proces regjistrimi
18	Apostol	Nasto	2765	132/1/12	574	52000	Proces regjistrimi
19	Telemak	Nasto	2765	132/1/13	596	52000	Proces regjistrimi
20	Raqi	Qirko	2765	132/1/16	1987	78000	Proces regjistrimi
21	Pandeli	Aupi	2765	132/1/17	4326	175500	Proces regjistrimi
22	Theodhoraq	Mano	2765	132/1/21	1050	65000	Proces regjistrimi
23	Petro	Konomi	2765	132/159	1601	156000	Proces regjistrimi
24	Elvira	Ceko	2765	132/5/3	900	130000	Proces regjistrimi
25	Panajot	Daji	2765	132/1/65	1789	195000	Proces regjistrimi
26	Luiza	Xhaxho	2765	132/1/37	408	78000	Proces regjistrimi
27	Thoma	Gela	2765	132/1/41	1533	97500	Proces regjistrimi
28	Pandeli	Vido	2765	132/1/39	627	58500	Proces regjistrimi
29	Kristaq	Sholla	2765	132/1/46	421	39000	Proces regjistrimi
30	Pandeli	Seva	2765	132/1/44	800	45500	Proces regjistrimi
31	Dhimiter	Daiu	2765	132/1/50	1780	91000	Proces regjistrimi
32	Llazar	Canoi	2765	132/1/51	1302	84500	Proces regjistrimi
33	Stavro	Papa	2765	132/1/54	642	52000	Proces regjistrimi
34	Grigor	Llano	2765	55/2/10	1180	26000	Proces regjistrimi
35	Koco	Diamanti	2765	132/1/57	1100	78000	Proces regjistrimi
36	Grigor	Papa	2765	132/1/61	615	39000	Proces regjistrimi
37	Antigoni	Franxhi	2765	68/1/132 ,19/1/132,	872	97500	Proces regjistrimi
38	Jorgaq	Papa	2765	132/1/67	759	52000	Proces regjistrimi
39	Filip	Xhani	2765	132/1/69	131	13000	Proces regjistrimi
40	Lluk	Mano	2765	119/5	569	130000	Proces regjistrimi
41	Kostandin	Andoni	2765	132/1/75	810	39000	Proces regjistrimi
42	Andrea	Andrea	2765	132/1/77	3971	312000	Proces regjistrimi

43	Mita	Jana	2765	132/1/78	942	136500	Proces regjistrimi
44	Aliqi	Papa	2765	132/1/31	530	97500	Proces regjistrimi
45	Grigor	Mano	2765	132/1/34	926	19500	Proces regjistrimi
46	Nikolla	Mano	2765	110/1	658	104000	Proces regjistrimi
47	Vangjel	Qirko	2765	107/6	996	84500	Proces regjistrimi
48	Ilia	Dupi	2765	107/8	1102	58500	Proces regjistrimi
49	Andrea	Diamanti	2765	105/4	2227	130000	Proces regjistrimi
50	Llambriini	Papa	2765	105/12	1435	78000	Proces regjistrimi
51	Vasil	Konomi	2765	131/3	548	91000	Proces regjistrimi
52	Llambro	Qirko	2765	119/9	1150	52000	Proces regjistrimi
53	Kristo	Qirko	2765	119/6	413	39000	Proces regjistrimi
54	Kristaq	Mano	2765	119/10	2377	149500	Proces regjistrimi
55	Pavlo	Konomi	2765	105/6	1728	71500	Proces regjistrimi
56	Pavli	Ceko	2765	57/5	667	123500	Proces regjistrimi
57	Andrea	Maka	2765	57/6	648	97500	Proces regjistrimi
58	Mihallaq	Toshi	2765	57/1	2630	104000	Proces regjistrimi
59	Llazi	Konomi	2765	55/2/1	1108	52000	Proces regjistrimi
60	Mihal	Shteto	2765	105/17	594	19500	Proces regjistrimi
61	Minella	Konomi	2765	119/4,119/7	1366	182000	Proces regjistrimi
62	Mihal	Canoi	2765	132/1/25;132/1/33	2030	195000	Proces regjistrimi
63	Avram	Paco	2765	132/1/63;132/1/81	1205	78000	Proces regjistrimi
64	Theodhoraq	Mano	2765	132/1/26	450	58500	Proces regjistrimi
65	Grigor	Mano	2765	132/1/34	926	26000	Proces regjistrimi
66	Dhimo	Qirko	2765	132/1/29	3200	279500	Proces regjistrimi
67	Pandeli	Ceko	2765	132/1/22,119/2	1321	123500	Proces regjistrimi
68	Goli	Pasko	2765	132/1/7,132/1/30	1900	123500	Proces regjistrimi
69	Maqo	Qirko	2765	132/1/1,132/1/72	1468	195000	Proces regjistrimi
70	Panajot	Papa	2765	132/5/7	498	78000	Proces regjistrimi
71	Pandeli	Shteto	2765	132/5/12	1268	104000	Proces regjistrimi
		Shuma				7091500	

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NË SEGMENTIN RRUGOR LEVAN –VLORË
PËR KULTURAT BUJQËSORE DHE DRUFRUTORE
QARKU: VLORË KOMUNA: NOVOSELË FSHATI: CERGOVINË, SKROFOTINË

Nr.	Emri	Mbiemri	ZK	Nr.Pas.	Nga kjo/Sip. e mbjellë	Bimë arash/Vlera lekë	Dru frutor/Vlera lekë	Totali lekë	Shënime
1	Rushan	Gjinollari	1379	205/17	1512	18144		18144	Konfirmim nga ZRPP
2	Zydi	Meta	1379	203/2	712	8544		8544	Konfirmim nga ZRPP
3	Farudin	Metaj	1379	203/1	169	2028		2028	Konfirmim nga ZRPP
4	Tahir	Shametaj	1379	203/11	3099	49584		49584	Konfirmim nga ZRPP
5	Novruz	Shametaj	1379	203/9	1157	13884		13884	Konfirmim nga ZRPP
6	Fuat	Shametaj	1379	203/12	681	10896		10896	Konfirmim nga ZRPP
7	Bekim	Metaj	1379	203/3	1073		170607	170607	Konfirmim nga ZRPP
8	Kristaq	Bregova	1379	67/28	1206		191754	191754	Konfirmim nga ZRPP
9	Selman	Mecaj	1379	203/6	1043	12516		12516	Konfirmim nga ZRPP
10	Lirim	Metaj	1379	203/4	614		97626	97626	Konfirmim nga ZRPP
	TOTALI					115596	459987	575583	

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

PËR KULTURAT BUJQËSORE DHE DRUFRUTORË

Nr.	Emri	Mbiemri	ZK	Nr.Pas.	Nga kjo/Sip. e mbjellë	Bimë arash/Vlera lekë	Dru frutor/Vlera lekë	Totali lekë	Shënime
1	Dhimitraq	Mocka	2813	45/13	1115	13380		13380	Konfirmim nga ZRPP
2	Trifon	Mocka	2813	45/30,45/17	3013	36155		36155	Konfirmim nga ZRPP
3	Pirro	Hyso	2813	44/15,54/30	1420	22720		22720	Konfirmim nga ZRPP
4	Jani	Carri	2813	54/1	945	15120		15120	Konfirmim nga ZRPP
5	Vasillaq	Hyso	2813	44/22	210	3360		3360	Konfirmim nga ZRPP
6	Leonidha	Hyso	2813	54/9	740	11848		11848	Konfirmim nga ZRPP
7	Gori	Lepuri	2813	44/2	441		107719	107719	Konfirmim nga ZRPP
8	Dhimitraq	Mocka	2813	54/4	1047		166473	166473	Konfirmim nga ZRPP
9	Vllasi	Mocka	2813	54/6	737		117183	117183	Konfirmim nga ZRPP
10	Josif	Carri	2813	43/73	747		118773	118773	Konfirmim nga ZRPP
11	Odise	Hyso	2813	44/12	1122		286200	286200	Konfirmim nga ZRPP
12	Kristaq	Hyso	2813	44/18	585		165000	165000	Konfirmim nga ZRPP
13	Vllasi	Lepuri	2813	54/27	381		60579	60579	Konfirmim nga ZRPP
14	Jani	Hyso	2813	54/11	386		82500	82500	Konfirmim nga ZRPP
15	Dhimitraq	Hyso	2813	44/9	535		110000	110000	Konfirmim nga ZRPP
16	Agron	Hyso	2813	44/8	544		165000	165000	Konfirmim nga ZRPP
17	Vangjel	Lepuri	2813	44/3	489		38955	38955	Proces Regjistrimi
18	Thoma	Mocka	2813	54/17	441		70119	70119	Konfirmim nga ZRPP
19	Katerina	Mocka	2813	54/16	323		51357	51357	E pasaktesuar
20	Llambi	Hyso	2813	54/10	545		86655	86655	Konfirmim nga ZRPP
21	Toli	Lepuri	2813	54/46	3650		407500	407500	Konfirmim nga ZRPP
22	Niko	Lala	2813	54/44	1259	20144		20144	Konfirmim nga ZRPP
23	Vasil	Lala	2813	54/47	2055	32880		32880	Konfirmim nga ZRPP
24	Mihal	Qarri	2813	54/3	772	12352		12352	Konfirmim nga ZRPP
						167959	2034013	2201972	

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE
FSHATI MIFOL

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NË SEGMENTIN LEVAN - VLORË
PËR KULTURAT BUJQËSORE DHE DRUFRUTORE

Nr.	Emri	Mbiemri	ZK	Nr.Pas.	Nga kjo/Sip. e mbjellë	Bimë arash/Vlera lekë	Dru frutor/Vlera lekë	Totali lekë	Shënime
1	Jorgji	Stasa	2689	8/32	1947		313866	313866	Konfirmim nga ZRPP
2	Pavli	Qarri	2689	131/7	1972	31552		31552	Konfirmim nga ZRPP
3	Dhori	Premti	2689	8/30,132/38	489	7824		7824	Konfirmim nga ZRPP
4	Aleksander	Carri	2689	7/33	2417	38672		38672	Konfirmim nga ZRPP
5	Vangjel	Mocka	2689	134/5	792	12672		12672	Konfirmim nga ZRPP
6	Llazi	Mocka	2689	134/2	444	7104		7104	Konfirmim nga ZRPP
7	Vasil	Mocka	2689	134/4	617	9872		9872	Konfirmim nga ZRPP
8	Jorgji	Qarri	2689	7/31	263	3156		3156	Konfirmim nga ZRPP
9	Thoma	Mocka	2689	134/3	663	10608		10608	Konfirmim nga ZRPP
10	Irakli	Prendi	2689	8/31	713	11408		11408	Konfirmim nga ZRPP
	TOTALI					132868	313866	446734	

Njoftojmë se kanë filluar abonimet për vitin 2011 për Fletoren Zyrtare.

Afati i abonimit mbaron më 31.1.2011.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 6.12.2010

Doli nga shtypi më 8.12.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja ADEL PRINT

Tiranë, 2010

Çmimi 36 lekë